

SOVRANITETI MONETAR, BANKAT
QENDRORE DHE NDËRVARËSIA MONETARE

Ajri Begu

Kryetar i Bordit të Guvernatorëve të BPK-Kosovë

Proceset integrative kanë marrë një rrugë pa kthim. Tashmë mund të thuhet se është krijuar një vetëdije e kënaqshme politike pro-integrimeve. Është interesante, por e vërtetë, besimi në proceset integrative është më i madh tek disa vende ish-komuniste se sa tek qytetarët e disa vendeve të tjera, të cilat supozohet se duhet të luajnë rol parësor ose më të drejtpërdrejtë. Nëse kjo bindje nuk është e rrejshme, atëherë kjo klimë duhet të shfrytëzohet edhe nga vendet e rajonit, ku mbahet kjo konferencë.

Historikisht njerëzit kanë ëndërruar pushtetin mbi paranë. Kush ka zotëruar paranë ka zotëruar të gjitha sferat e jetës. Sovraniteti monetar është një nga shtyllat kryesore të ekonomive kombëtare. Mbi këtë pushtet kanë përfituar, kanë spekuluar, janë ngritur por edhe kanë rënë shumë sovranë. Paraja nuk duron sovranë, ajo vetë është sovranë! Kush nuk e njeh këtë logjikë dhe kush nuk i di këto ligje mund të nxjerrë përfitime momentale, mirëpo fundin do ta paguajë me fajde. Në fakt, fajden e paguajnë qytetarët e sovranit ose sovranëve. Qytetarët paguajnë duke u varfëruar, kurse sovranët marrin dënimin moral, politik dhe herë-herë edhe penal.

Jo rastësisht u ndala tek abuzimi me sovranitetin monetar. Kjo pririje gjithnjë e ka ndjekur dhe e ndjek paranë. Mirëpo, derisa tek ekonominë dhe demokracinë e stabilizuara një gjë e tillë nuk mund të imagjinohet me demokracinë e reja nuk është kështu. Përvoja dhjetëvjeçare e vendeve të ish-blokut komunist ka shumë raste, të cilat provojnë abuzime të përmasave skandaloze. Ku më shumë e ku më pak, në të gjitha pa përjashtim. Dhe, të gjitha këto ndodhin derisa në fqinjësinë e këtyre vendeve, në Europë, vullnetarisht dymbëdhjetë shtete kanë hequr dorë nga sovraniteti monetar kombëtar për të participuar në një valutë të përbashkët, *euro*.

Euro relativizon sovranitetin monetar dhe rolin e bankave kombëtare. Euro është simbol i ndërvarësisë monetare të vendeve që e kanë përqafuar atë, por jo vetëm i tyre.

Me valutën e përbashkët industria bankare dhe tregu fitojnë impulse të reja, mirëpo në anën tjetër, edhe euro duhet parë si produkt i internacionalizimit të aktiviteteve financiare, si produkt i integritit të tregut të kapitalit dhe si produkt të pagesave të mëdhaja, të cilat kanë krijuar lidhshmëri të reja ndërbankare. Pra, monedha e përbashkët është në lidhje interaktive me proceset globale.

Në vitin e dytë të mileniumit të tretë një valutë do ta marrë rolin integrativ, kurse vendet e Eurozonës guxoj t'i quaj shtet financiar ose shtet valutator. Në këtë milenium, në vend të ushtrive dhe integritimeve të dhunshme, Europa e Bashkuar na jep shembullin dhe modelin e integritimeve të ardhshme.

Siç thashë në fillim, në këtë pjesë të Europës është krijuar një vetëdije pro integritimeve. Në qoftë se heqim një paralele me Europën dhe euron gati të gjitha vendet, pa përjashtim, mbështesin idenë e integritit në Europë. Sa i përket valutës, shumica e tyre, përkundër krenarisë së theksuar kombëtare, do të hiqnin dorë nga ato, sidomos qytetarët. Ata edhe ashtu, duke mos u besuar valutave nacionale, kursimet e tyre i mbajnë në valuta të forta. Kosova dhe Mali i Zi kanë pranuar një valutë të huaj për valutë kombëtare (markën gjermane). Shkaku ëshë i njëjtë, të mbrohen nga keqpërdorimi i valutës.

Integritet monetare nuk mund të bëhen pa integritet politike, mirëpo valuta atyre nuk u hap rrugë, kurse integritet politike në këtë pjesë të Europës janë shumë të vështira. Por, jo edhe të pamundshme. Është koha dhe momenti i volitshëm që të veprohet energjikisht. Të shfrytëzohet disponimi pro integritimeve. Natyrisht,

qytetarët dhe politikanët këtu shohin shpresën. Europa duhet të ofrojë projekt, ku të gjithë do ta shihnin perspektivën. Mbrojtja më e mirë nga "të sëmurët" është shërimi i tyre dhe jo izolimi nga ata. Një asistencë frontale legjislative, teknike dhe financiare është e domosdoshme për të gjitha ato vende, të cilat shprehin gatishmërinë që përmes integrimeve rajonale të hyjnë në Europën e Bashkuar. Nëse do të inicohej një projekt i tillë global me kushtet, por edhe me perspektivën pasi do t'i kishin plotësuar kushtet, unë nuk shoh se do të kishte ndonjë problem që vendet e rajonit (por edhe rajone të tjera të ngjashme) ta refuzonin atë.

Për valutën thuhet se ajo është pasqyra më e mirë e një vendi. Dhe nëse do të kishte marrëveshje politike për integrime rajonale, duhet filluar me valutën. Mendoj se një valutë e përbashkët **Euro-A** do të mund ta lozte rolin e njëjtë si në vendet e Eurozonës. **A**-ja këtu është asocuar. **Euro-A** mund të fiksohej me kursin e euros, ashtu siç ka vepruar Bosnja dhe Hercegovina me markën gjermane. Dhe emërtimi **Euro-A** nuk është i rastësishëm, përkundrazi ai tregon perspektivën. Banka Qendrore Europiane do të duhej ta përkrahte dhe të ofronte të gjithë asistencën e duhur deri në fuzionimin e **Euro-A** në euron e vërtetë. Bankat kombëtare do të duhej të hiqnin dorë nga sovraniteti monetar dhe këtë sovranitet ta përcillnin në një bankë qendrore rajonale të mbikëqyrur nga Banka Qendrore Europiane.

Përparësitë e një valute të përbashkët do të ishin të shumta. Do të zhvillohej industria bankare dhe do të pasurohej tregu financiar i vendeve, të cilat do të pranonin këtë valutë, do të hapeshin mundësi më të mëdha për mobilizimin dhe alokimin e kapitalit , do të bëheshin më të lehta dhe më të lira transaksionet ekonomike dhe financiare, do të hapeshin mundësi për investime të përbashkëta dhe, përfundimisht, do të krijohej stabiliteti financiar.

Natyrisht, për t'i hapur rrugën valutës së përbashkët do të duhet adoptuar një pako e tërë ligjesh, të cilat prekin edhe sfera të tjera të jetës dhe kështu këto vende jo vetëm që do të jenë kompatible me njëra-tjetrën, por do të jenë kompatible me Europën.

Euro-A është projekti më i mirë që mund t'ia ofrojmë Europës, njëkohësisht edhe Europa këtë duhet ta shohë projektin më me prespektivë ku duhet investuar.

Kjo është një ide, një ëndërr, por të gjitha fillojnë nga ëndrrat.